



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

Data: 3.5.2023

Nr: 62

Ora: 12:00

**U R D H Ë R**

**PËR**

**ZBATIMIN E DISA RREGULLAVE PËR PERSONAT E PRANISHËM NË TERRITORIN E OBJEKTEVE  
ZGJEDHORE KU JANË VENDOSUR QENDRAT E VOTIMIT, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES  
VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronja “dh” dhe pika 2, dhe nenit 109 e nenit 110, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr.11, datë 25.3.2021, të Komisionit Rregullator, “Për mënyrën e ngritjes, organizimit dhe funksionimit të Komisioneve të Qendrave të Votimit”, të ndryshuar, dhe vendimit nr.12, datë 30.12.2020, “Për miratimin e rregullave të veprimtarisë së Policisë së Shtetit në shërbim të zgjedhjeve”, me qëllim garantimin e rregullit përgjatë procesit të votimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023,

**U R D H Ë R O J:**

1. Në qendrën e votimit dhe përreth saj mund të qëndrojnë vetëm:
  - a) Anëtarët e komisionit të qendrës së votimit;
  - b) Zgjedhësit në radhë për të votuar;
  - c) Vëzhguesit e akredituar;
  - ç) Përfaqësuesit e akredituar të medias;
  - d) Punonjësit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ); dhe
  - dh) Anëtarët e komisionit të zonës së administrimit të zgjedhjeve (KZAZ).
2. Ndalimin e qëndrimit dhe/ose të grumbullimit në mjediset jashtë qendrës së votimit, në oborrin e ndërtesës, në hyrje të saj, në korridoret e brendshme të ndërtesës ku është/janë të vendosura qendrat e votimit dhe përreth tyre në një distancë rrethore me rreze më të vogël se 150 m, të personave të tjerë, përveç atyre të përcaktuar në pikën 1, të këtij urdhri.

Data: 3.5.2023 Nr.62  
Ora:12:00



“Për zbatimin e disa rregullave për personat e pranishëm në territorin e objekteve zgjedhore ku janë vendosur qendrat e votimit, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”

3. Zgjedhësi i cili shkon për të votuar, drejtohet për në hyrjen e qendrës së votimit, vendoset në radhë dhe pasi ka përfunduar procesin e votimit duhet të largohet menjëherë nga qendra votimit si dhe nga ambientet e tjera të brendshme, apo nga oborri i godinës ku është vendosur qendra/qendrat e votimit.
4. KQV-ja merr vendim për pezullimin e votimit dhe njofton KZAZ-në dhe Policinë e Shtetit në rastin kur verifikohet mosrespektimi i pikave 1, 2 dhe 3, të këtij urdhri.
5. Në rast se KQV-ja nuk merr vendim, anëtari apo sekretari i KQV-së, që konstaton këtë fakt, mban një procesverbal dhe njofton menjëherë KZAZ-në përkatëse, KQZ-në dhe Policinë e Shtetit.
6. Në rast se KZAZ-ja nuk merr vendim për të njoftuar Policinë e Shtetit, çdo anëtar apo sekretari i KZAZ-së, pasi ka konfirmuar informacionin njofton menjëherë KQZ-në dhe organet e Policisë së Shtetit, nëpërmjet formularit për kërkimin e ndihmës së Policisë së Shtetit model KQZ-04-13, për të marrë masat e nevojshme për të larguar personat që nuk lejohen të qëndrojnë pranë ambienteve të qendrave të votimit, sikurse përcaktohet në pikat 1, 2 dhe 3, të këtij urdhri, si dhe aktet nënligjore të KQZ-së.
7. Krahas sa përcaktohet më sipër në këtë urdhër, çdo anëtar i KQV-së, i KZAZ-së, vëzhgues apo zgjedhës, kur konstaton shkelje të këtij urdhri, apo të akteve të tjera ligjore apo nënligjore në lidhje me praninë e personave të paautorizuar në mjediset përreth qendrës së votimit, në oborrin e ndërtesës, në hyrje të saj, në korridoret e brendshme të ndërtesës ku është/janë të vendosura qendrat e votimit dhe përreth tyre në një distancë rrethore me rreze më të vogël se 150 m, njofton menjëherë KQZ-në nëpërmjet numrit të telefonit të venë në dispozicion të administratës zgjedhore (aplikacioneve *Whatsapp* dhe *Telegram*) apo nëpërmjet aplikacionit KQZ.
8. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare elektronike të KQZ-së.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

Kopje: 3  
Afati i ruajtjes: 3 vjet  
Punoji:  
E.Meta \_\_\_\_\_  
M.Çelmeta \_\_\_\_\_  
Y.Merkaj \_\_\_\_\_

Data: 3.5.2023 Nr.62  
Ora:12:00



“Për zbatimin e disa rregullave për personat e pranishëm në territorin e objekteve zgjedhore ku janë vendosur qendrat e votimit, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”